



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



ANEKS KONTRATË

Numri i kontratës:¹ 626-23-4448-5-3-5/C136

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

Dhe

Operatori Ekonomik Multi Business Group SH.P.K. me numër të biznesit: 811033258 Selia në Prizren, Rruga Mazllum Kastrati, të cilën e përfaqëson z. Jeton Bytyqi në cilësinë e Drejtorit të O.E. (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një aneks kontratë publike për punë shtesë të shënuara më poshtë:

Titulli i Tenderit: "Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në Komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave"-Faza e dytë-Punë shtesë me numër identifikues: 626-23-4448-5-3-5 dhe nr. të brendshëm 626-23-009-5-3-5

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës ka të bëjë me kryerjen e punëve shtesë për ndërtimin e fazës së dytë të projektit mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në Komunën e Mamushës, nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave nga Kontraktuesi, menjëherë pas nënshkrimit të kësaj aneks kontrate, sipas pozicioneve të punëve shtesë të cilat janë aprovuar nga Menaxheri i Kontratës, Kryetari i Komunës dhe për të cilat është njoftuar edhe KRPP në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 neni 35.1. për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Punët do të kryhen brenda afatit prej 10 (dhjetë) ditëve.

Në emër të kësaj aneks kontrate Operatori Ekonomik do ti kryej punët si në vijim:

"Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave" Faza e dytë-Punët shtesë			
Materiali - punët ndërtimore dhe elektromontuese Faza 2-Punët shtesë			
Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

1	Kabllo X00/0-A, 1kV 3x50+50/8 mm ² Në kuadër të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë Furnizimi me material të imët nga kontraktori si lidhëse rrymore (Fidos, Unimax) sipas nevojës, lidhëse - gëzhoja izoluese (MUF), etj.	m	190.00
2	Kabllo X00/0-A, 1kV 3x70+61/10 mm ² Në kuadër të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë Furnizimi me material të imët nga kontraktori si lidhëse rrymore (Fidos, Unimax) sipas nevojës, lidhëse - gëzhoja izoluese (MUF), etj.	m	100.00
4	Unaza mbërthyes me vegë nga çeliku për varje dhe tërheqje të kablrit ABC shtylla këndore-me diameter 200-250mm Në kuadër të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	9.00
7	Shtërnguese tërheqëse për kabëll bistëk ABC -për përquesin zero . për seksion 4X(35-71.5)mm ² , 0.4 kV Në kuadër të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	10.00
9	Konzolle Universale nga alumini për kabëll ABC , 0.4 kV Në kuadër të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	20.00

11	Shtylla të tensionit të ulët (TU) këndore prej betonit me gjatësi 9 [m] tip SHB 9/1000, Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: - Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë - hapja e themelit të shtyllës dhe largimi i dheut deri në deponi, - furnizimi me beton të klasës C 20/25 si dhe betonimi i themelit me dimensione (1.0 x 1.0 x 1.5) m, - vendosja e dy gypave Ø 400 mm -gjatesie 1.0 m dhe 0.5 m, - shtypja e tabelave vërejtëse me numrat rendorë të shtyllave këndore	Copë	10.00
15	Gyp Ø400 mm prej betoni me gjatësi 0.5 m Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: Furnizimi me material kryesor. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	10.00
16	Gyp Ø400 mm prej betoni me gjatësi 1.0 m Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: Furnizimi me material kryesor. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	10.00

Neni 2

Kjo aneks Kontratë lidhet në mes palëve kontraktuese duke u mbështetur në nenin 35 Paragrafi 2.4 pika (ii) të LPP-s si dhe në kontratën e datës **23.03.2023** e lidhur ndërmjet Komunës së Mamushës si Autoritet Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik **Multi Business Group SH.P.K.** për projektin me titull: **"Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave"** Faza e dytë. Palët nënshkruese të kontratës pajtohen që të nënshkruajnë këtë aneks Kontratë, për vazhdimin e punëve shtesë të cilat kanë dalë si pasojë e mos parashikimit të sasisë të kërkuar në kontratën bazë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i furnizimeve do të jetë, gjithsejtë: **9,000.00 €;**

Nëntë mijë Euro.

3.2 Çmimi i punëve është dhënë në ofertën financiare të kontraktuesit. Çmimi total i kontratës është dhënë në euro.

3.3 Çmimi që i referohet paragrafit 3.1 me lartë do të jete e vetmja pagesë që e ka borxh autoriteti kontraktues ndaj kontraktuesit sipas aneks kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe nuk mund te ndryshohet.

3.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e Veçanta të kontratës bazë.

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën, konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë në kontratë të datës **23.03.2023**.

Neni 4 Komunikimet

Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë aneks kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë, dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit, dhe duhet të dërgohen me postë, faks, e-mail: ose të dorëzohen personalisht sipas kontratës bazë të parapara në Kushtet e Veçanta.

Neni 5 Sigurimi i ekzekutimit

Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% apo **900.00 EUR** për periudhën prej **dyzetë (40)** ditëve.

Neni 6

E hartuar në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Neni 7

Të gjitha nenet tjera të kontratës mbeten në fuqi dhe do të zbatohen sipas kushteve dhe ligjit të cekur në kontratë të datës **23.03.2023** me numër të prokurimit **626-23-137-5-2-1** dhe titull: "Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave" Faza e dytë.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Gazmend Gashi	Emri:	Jeton Bytyqi
Pozita:	Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit	Pozita:	Drejtore
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	01.06.2023	Data:	01.06.2023
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: “Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në Komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave”-Faza e dytë-Punë shtesë

Nr i prokurimit	626-23-4448-5-3-5
Nr i brendshëm	626-23-009-5-3-5

"Mbështetja e zhvillimit të hovshëm të prodhimeve bujqësore në komunën e Mamushës nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës elektrike në zonën e serrave" Faza e dytë-Punët shtesë					
Materiali - punët ndërtimore dhe elektromontuese Faza 2-Punët shtesë					
Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1	Kabllo X00/0-A, 1kV 3x50+50/8 mm ² Në kuader të kesaj duhet të përfshihen: Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë Furnizimi me material të imët nga kontraktori si lidhëse rrymore (Fidos, Unimax) sipas nevojës, lidhëse - gezhoja izoluese (MUF), etj.	m	190.00	12	2280
2	Kabllo X00/0-A, 1kV 3x70+61/10 mm ² Në kuader të kesaj duhet të përfshihen: Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë Furnizimi me material të imët nga kontraktori si lidhëse rrymore (Fidos, Unimax) sipas nevojës, lidhëse - gezhoja izoluese (MUF), etj.	m	100.00	12.5	1250

4	Unaza mbërthyesë me vegë nga çeliku për varje dhe tërheqje të kablit ABC shtylla këndore-me diametër 200-250mm Në kuader të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	9.00	10	90
7	Shtërnguese tërheqëse për kabëll bistëk ABC -për përquesin zero . për seksion 4X(35-71.5)mm ² , 0.4 kV Në kuader të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	10.00	8	80
9	Konzolle Universale nga alumini për kabëll ABC , 0.4 kV Në kuader të kësaj duhet të përfshihen: Furnizimi me material kryesor si dhe material të imët. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	20.00	10	200
11	Shtylla të tensionit të ulët (TU) këndore prej betonit me gjatësi 9 [m] tip SHB 9/1000, Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: - Furnizimi dhe montimi sipas projektit dhe lëshimi në punë - hapja e themelit të shtyllës dhe largimi i dheut deri në deponi, - furnizimi me beton të klasës C 20/25 si dhe betonimi i themelit me dimensione (1.0 x 1.0 x 1.5) m, - vendosja e dy gypave Ø 400 mm -gjatësie 1.0 m dhe 0.5 m, - shtypja e tabelave vërejtëse me numrat rendorë të shtyllave këndore	Copë	10.00	450	4500
15	Gyp Ø400 mm prej betoni me gjatësi 0.5 m Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: Furnizimi me material kryesor. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe	Copë	10.00	30	300

	lëshimi në punë				
16	Gyp Ø400 mm prej betoni me gjatësi 1.0 m Në kuadër të kësaj duhet të parashihen: Furnizimi me material kryesor. Instalimi në hapësirën sipas projektit dhe lëshimi në punë	Copë	10.00	30	300

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	MULTI BUSINESS GROUP SHPK
ADRESA E PLOTE	RR. MAZLLUM KASTRATI PN
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	JETON BYTYQI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	15.5.2023
VULA	